

**Microsoft Albania sh.p.k.**  
**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe**  
**Pasqyrat Financiare**  
**për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022**

## **Përmbajtja**

	<b>Faqe</b>
<b>Raporti i Audituesit të Pavarur</b>	
<b>Pasqyra e pozicionit financiar</b>	<b>4</b>
<b>Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>	<b>5</b>
<b>Pasqyra e ndryshimeve në kapital</b>	<b>6</b>
<b>Pasqyra e flukseve të parasë</b>	<b>7</b>
<b>Shënimet e pasqyrave financiare</b>	<b>8 – 33</b>

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

### Aksionarëve dhe Drejtuesve të Microsoft Albania Sh.p.k,

#### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të veçanta të Microsoft Albania sh.p.k, (“Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2022 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2022 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare të veçanta për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF-të”).

#### Bazat për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar “Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare ” të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës (“BKSNE”) dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

#### Përgjegjësitë e drejtuesit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtuesit, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare drejtuesit është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtuesit ka ose për qëllim të likuideojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## **Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrollleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrollleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtuesit.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtuesit, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

## Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.

*Deloitte Audit Albania sh.p.k*

Deloitte Audit Albania sh.p.k

Rr.Kavajes, Ish parku i mallrave, Kompleksi Delijorgji,

Godina H, Kati 2,

Tirana, Albania

Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS): L41709002H



*Enida Cara*

Partner Angazhimi

Auditues ligjor

Enida Cara

23 Qershor, 2023

Tiranë, Shqipëri

**Microsoft Albania sh.p.k.****Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2022***(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

	Shënimet	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
<b>Aktivet</b>			
<b>Aktivet afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	6	365	3,712
E drejta e përdorimit të aktiveve	7	1,141	3,326
Aktive tatimore të shtyra	8	497	1,210
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>2,003</b>	<b>8,248</b>
<b>Aktivet afatshkurtra</b>			
Parapagime dhe shpenzime të periudhave të ardhme	9	1,602	1,602
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	10	138,469	60,788
Paraja dhe ekuivalentet e saj	11	154,229	87,027
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>294,300</b>	<b>149,417</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>296,303</b>	<b>157,665</b>
<b>Kapitali dhe detyrimet</b>			
Kapitali aksionar	12	100	100
Fitimi i pashpërndarë		257,298	133,070
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>257,398</b>	<b>133,170</b>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Detyrime afatshkurtra qiraje	13	1,121	3,465
Detyrime kontraktuale	14	10,882	11,524
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	15	16,005	7,394
Detyrime tatimore	16	10,897	2,112
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>38,905</b>	<b>24,495</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>38,905</b>	<b>24,495</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>296,303</b>	<b>157,665</b>

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm më 23 qershor 2023 dhe janë firmosur nga:

Joli Pijaneci  
Perfaqësuese Ligjore



Përgatitur nga:

Ernst & Young Albania sh.p.k



Shënimet shpjeguese në faqet 8 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Microsoft Albania sh.p.k.****Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
<b>Te ardhurat</b>	<b>17</b>	<b>229,670</b>	<b>107,217</b>
Shpenzime personeli	<b>18</b>	(2,157)	(2,686)
Shpenzime operative të tjera	<b>19</b>	(10,751)	(15,344)
Shpenzime amortizimi	<b>6,7</b>	(7,593)	(7,784)
<b>Fitimi operativ</b>		<b>209,170</b>	<b>81,403</b>
Shpenzime interesi	<b>20</b>	(43)	(134)
Humbje nga kursi i këmbimit, neto	<b>21</b>	(2,613)	(542)
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>206,514</b>	<b>80,727</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	<b>22</b>	(32,286)	(12,670)
<b>Fitimi neto për vitin</b>		<b>174,228</b>	<b>68,057</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>174,228</b>	<b>68,057</b>

*Shënimet shpjeguese në faqet 8 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

**Microsoft Albania sh.p.k.****Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>Fitimi i pashpërndarë</b>	<b>Totali</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2021</b>	<b>100</b>	<b>95,013</b>	<b>95,113</b>
Fitimi neto i vitit	-	68,057	68,057
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	-
Dividend i paguar në vitin	-	(30,000)	(30,000)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>100</b>	<b>133,070</b>	<b>133,170</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2022</b>	<b>100</b>	<b>133,070</b>	<b>133,170</b>
Fitimi neto i vitit	-	174,228	174,228
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	-
Dividend i paguar	-	(50,000)	(50,000)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	<b>100</b>	<b>257,298</b>	<b>257,398</b>

*Shënimet shpjeguese në faqet 8 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*



	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
<b>AKTIVITETE OPERATIVE</b>			
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>206,514</b>	<b>80,727</b>
Rregullime për:			
Amortizimin e aktiveve afatgjata materiale	6	3,347	3,557
Amortizimin e të drejtës së përdorimit të aktiveve	7	4,460	4,625
<b>Flukset e parasë nga aktiviteti operativ përpara ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative</b>		<b>214,321</b>	<b>88,908</b>
<i>Ndryshimi në kapitalin punues</i>			
Rënie në parapagime dhe shpenzime të periudhave të ardhme		-	66
Rritje në llogari të arkëtueshme dhe të tjera		(77,681)	(1,763)
Rritje në aktivet tatimore		-	(1,854)
Rritje në detyrimet kontraktuale		(642)	7,183
Rënie në llogaritë e pagueshme dhe detyrime tatimore		8,611	7,302
Rritje në detyrimet e qirasë		(37)	(121)
Interesi për detyrimin e qirasë		43	134
Tatimi fitimi i paguar		(22,787)	(2,606)
<b>Flukset e parasë neto nga / (të përdorura) në veprimtarinë operative</b>		<b>121,828</b>	<b>97,250</b>
<b>AKTIVITETE INVESTUESE</b>			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale		-	-
<b>Flukset e parasë neto e përdorur në aktivitetet investuese</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>AKTIVITETE FINANCUESE</b>			
Pagesat e principalit të qirasë	24	(4,625)	
Divident i paguar		(50,000)	(30,000)
<b>Flukset e parasë neto të përdorur në aktivitetet financuese</b>		<b>(54,625)</b>	<b>(34,674)</b>
<b>Rritje neto e parasë</b>		<b>67,202</b>	<b>62,576</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit</b>	<b>11</b>	<b>87,027</b>	<b>24,451</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit</b>		<b>154,229</b>	<b>87,027</b>

## **1. TË PËRGJITHSHME**

Microsoft Albania (“Shoqëria”) është themeluar më 30 qershor 2008 si Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe u regjistrua sipas vendimit të gjykatës në të njëjtën datë, me NIPT K8183001C.

Aksionari i Shoqërisë është Microsoft Corporation (Shoqëria Mëmë), e cila zotëron 100% të aksioneve. Microsoft është një korporatë software-sh me bazë në SHBA, e regjistruar më 22 shtator 1993, me seli në Redmond, Washington, SHBA.

Microsoft Corporation është entiteti kontrollues i drejtpërdrejtë dhe përfundimtar i Shoqërisë.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është ofrimi i shërbimeve për zhvillimin e tregut, shërbimet të kualifikuara dhe shërbimet që lidhen me software dhe hardware kompjuterike, përfshirë pa asnjë kufizim, shërbime teknike, trajnime dhe këshillime.

Më 31 dhjetor 2022, Shoqëria ka 1 punonjës (2021: 1). Zyrat e Shoqërisë ndodhen në Rruga e Kavajes, Ndertesa nr. 27, Kati 5, Njesia bashkiake nr. 10, Tiranë, Shqipëri, që nga nëntor 2022 (adresa e mëparshme ka qenë Rr. Papa “Gjon Pali II”, ABA Business Center, Floor 12/5, 1000, Tiranë, Shqipëri).

### **Drejtuesit dhe Manaxherët më 31 dhjetor 2022 dhe 2021:**

Benjamin Owen Orndorff

Administrator

Keith Ranger Dolliver

Administrator

Joli Pijaneci

Perfaqesuese Ligjore nga 15.02.2020 deri më sot

## **2. BAZA E PËRGATITJES**

### **2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”) të cilat janë publikuar dhe nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, (SNK).

### **2.2 Baza e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë te kostos historike.

### **2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë paraqitur në monedhën Leke Shqiptarë (“LEK”), dhe të gjitha vlerat janë rrumbullakosur në mijëshen me të afërt “000 lekë”) përveçse kur tregohet ndryshe. LEK është monedha funksionale dhe e paraqitjes se Shoqërisë.

Pasqyrat financiare ofrojnë informacion krahasues në lidhje me periudhën e mëparshme.

### **2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave te raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën këto vlerësime janë rishikuar dhe në periudhat e ardhshme që ndikohen.

## **2. BAZA E PËRGATITJES (VAZHDIM)**

### **2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve (vazhdim)**

#### *Parimi i vijimërisë*

Drejtimi i ka përgatitur Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 mbi bazën e parimit të vijimësisë, i cili merr të mirëqenë vazhdimësinë e aktivitetit aktual të biznesit, realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve në rrjedhën e zakonshme të aktivitetit biznesor.

Bazuar në marrëveshjen dypaleshe ne fuqi midis entiteteve të Korporates Microsoft që udhëzon modelin operacional të zbatueshem për Shoqerine, kësaj të fundit i garantohet një mbulim i kostove të saj lokale operacionale të periudhës në rast se ajo nuk gjeneron të ardhura të mjaftueshme nga shërbimet ndaj klienteve që janë pale të treta (Shërbimet Microsoft të Konsulencës - MCS dhe Shërbimet Mbeshtetese Premier - PSS). Në sajë të zbatimit të kontratave të reja të nënshkruara në 2021 për shërbimet profesionale të konsulencës–MCS dhe shërbimet mbështetese Premier– PSS si dhe me lidhjen e kontratave të reja për shërbimet PSS me kliente vendore që janë agjensi shtetërore gjatë vitit 2022, veprimtaria dhe rezultatet operacionale dhe financiare e Shoqërisë janë rritur ndjeshëm. Gjithashtu, persa I takon menaxhimit të burimeve dhe mjeteve monetare, ne baze të një marrëveshjeje të brendshme e zbatueshme nga Korporata Microsoft, për menaxhimin e centralizuar të mjeteve monetare, Shoqëria ne baze të marrëveshjes në fjale, mund të kërkojë të terheqë në çdo kohë mjete të saj monetare nga gjendja e saj e llogarive të arketueshme nga të ardhurat e komisioneve, për perballimin e nevojave të saj imediate operacionale.

Drejtimi nuk pret ndonjë ndryshim të qënësishëm në aktivitetin e Shoqërisë. Drejtimi vazhdon të vlerësojë ndikimin e ngjarjeve globale – sic janë situata pas epidemisë COVID-19, kriza globale e energjisë që pasoi si dhe lufta në Ukrainë – në performancën operacionale dhe financiare të Shoqërisë. Ngjarje të tilla nuk patën ndikim të drejtëpërdrejtë në operacionet e Shoqërisë dhe nuk është identifikuar asnjë tregues për të hedhur dyshime mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar veprimtarinë ekonomike në bazë të parimit të vijimësisë së biznesit në të ardhmen.

#### *Klasifikimi si afatshkurtër dhe afatgjatë i zërave të pasqyrave financiare*

Shoqëria i paraqet aktivet dhe detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar bazuar në klasifikimin si afatshkurtër / afatgjatë. Një aktiv konsiderohet si afatshkurtër kur:

- Ai pritët që të realizohet apo synohet që të shitet ose konsumohet brenda ciklit normal të veprimtarisë operacionale të Shoqërisë
- Mbahet kryesisht për qëllime të tregtimit
- Pritët që aktivi të realizohet brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit.

Ose

- Është në formën e mjeteve monetare ose të një aktivi ekuivalent të mjeteve monetare, me përjashtim të rastit kur ai kufizohet për t'u përdorur për këmbim ose për shlyerjen e një detyrimi për të paktën dymbëdhjetë muaj mbas periudhës së raportimit

Të gjitha aktivet e tjera do të konsiderohen si afatgjata.

Një detyrim është afatshkurtër kur:

- Pritët që të shlyhet gjatë ciklit normal të veprimtarisë operacionale të Shoqërisë
- Mbahet kryesisht për qëllime të tregtimit
- Do të shlyhet brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit

Ose

- Nuk ka një të drejtë të pakushtëzuar mbi të që të shtyjë shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas periudhës së raportimit.

Shoqëria i klasifikon të gjitha detyrimet e tjera si afatgjata.

## **2. BAZA E PËRGATITJES (VAZHDIM)**

### **2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve (vazhdim)**

Aktivitet dhe detyrimet e tatimeve të shtyra klasifikohen si aktive dhe detyrime afatgjata.

#### *Treguesi i realizimit të shërbimeve*

Njohja e të ardhurave bazohet në treguesit e realizimit të shërbimeve të kryera. Drejtimi kryen vlerësimin e vet se si do të matet puna e realizuar, kjo punë do të miratohet nga inxhinierët dhe treguesi i realizimit do të bazohet mbi numrin e orëve të punës faktikisht të shpenzuara kundrejt totalit të numrit të orëve të parashikuara për kryerjen e punës. Hollesi të tjera janë paraqitur në shenimin 3.5.

#### *Njohja e aktivitetit tatimor të shtyrë*

Njohja e aktivitetit tatimor të shtyrë bazohet në faktin nëse ka më shumë mundësi sesa jo, që të ketë fitime të mjaftueshme në dispozicion në të ardhmen, kundrejt të cilave mund të zbriten diferencat e përkohshme të njohura. Keshtu që njohja e aktivitetit tatimor të shtyrë kërkon gjykim në lidhje me rezultatet e ardhshme të Shoqërisë.

## **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL**

### **3.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj rregjistrohen fillimisht në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën në të cilën transaksioni percaktohet që duhet të njihet. Aktivitet dhe detyrimet e zerave monetare të matura në monedha të huaja përkthehen në monedhën funksionale (LEK) me kursin e këmbimit që prevalon në datën e raportimit. Diferencat që vijnë nga shlyerja ose konvertimi i zerave monetarë njihen në fitim ose humbje, me përjashtim të zerave monetarë që janë caktuar si pjesë e investimit të Shoqërisë në një aktivitet (investim) të huaj, nëse ka, të cilat njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ) derisa investimi neto të shitet, në të cilin moment, vlera kumulative do të riklasifikohet në fitim ose humbje. Detyrimet apo aktivitetit tatimore që i atribuohen diferencave nga kursi i këmbimit të njohura nga kjo kategori të zerave monetarë do njihen gjithashtu në ATGJ

Zerat jo-monetare që maten në bazën e kostos historike në një monedhë të huaj, përkthehen në monedhë funksionale duke përdorur kursin e këmbimit që ka prevaluar në datën e transaksionit fillestar. Zerat jo-monetarë të bilancit që maten me vlerë të drejtë në një monedhë të huaj përkthehen në monedhë funksionale duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është percaktuar vlera e drejtë. Fitimi ose humbja që rrjedh nga përkthimi i zerave jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë trajtohet në të njëjten mënyrë si dhe fitimi ose humbja e njohur nga ndryshimi në vlerën e drejtë të zërit në fjalë. Kursi efektiv në fund të vitit ndërmjet LEK'ut dhe monedhave të tjera të huaja është si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
USD	107.05	106.54
EUR	114.23	120.76

### **3.2 Aktivitet afatgjata materiale**

#### *Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga zhvlerësimi i vlerës së tij. Punimet në proces, maten me kosto, minus humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kjo kosto përfshin koston e zëvendësimit të makinerive dhe pajisjeve si dhe koston e huamarrjes në rastin e projekteve afatgjata të ndërtimit nëse janë përbushur kushtet për njohjen e aktivitetit.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.2 Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)**

*Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe koston direkte të punës, çdo kosto tjetër te ciles i atribuohet sjellja e aktivitetit në kushtet e punës për qëllimin e përcaktuar, koston e çmontimit dhe largimit të pjesëve dhe restaurimit të vendit në të cilin ato janë vendosur si dhe koston e kapitalizuara të huamarrjes.*

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme ato njihen ne kontabilitet si elemente të veçante (komponente kryesore) të aktiveve afatgjata materiale.

Nje ze aktivi afatgjate material apo nje komponent kryesor i nje aktivi i njohur individualisht, çregjistrohet ne momentin kur aktivi shitet, transferohet (dmth ne daten kur bleresi merr kontrollin mbi aktivin) ose kur nuk priten përfitime ekonomike në të ardhmen nga përdorimi apo shitja e tij.

Të ardhurat apo humbjet që lindin ne momentin e rregjistrimit te një aktivi afatgjatë material (te llogaritura si diference midis te ardhurave nga shitja dhe vlerës se tij kontabël neto) njihen ne pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve kur aktivi cregjistrohet.

#### ***Kostot të mëpasshme***

Nëse është e mundshme që përfitime ekonomike që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në të ardhmen në Shoqëri dhe kostoja e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme, kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet me vlerën kontabël të elementit. Vlera e mbetur e pjesës së zëvendësuar çregjistrohet. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave në momentin kur ato ndodhin.

#### ***Amortizimi***

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivitetit, ose një vlerë zëvendësuese e koston, minus vlerën e tij të rikuperueshme. Amortizimi njihet në fitim apo humbje ne bazë lineare përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të secilit grup të aktiveve afatgjata materiale, duke qenë së kjo shperndarje reflekton më mirë modelin e pritshëm të konsumimit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të trupëzuara në një aktiv.

<i>Kategoritë</i>	<i>Vitet</i>
Pajisje zyre	3
Automjete	3
Mobilje dhe orendi	3
Pajisje dhe programe kompjuterike	1-2
Permiresimet e ambjenteve te marra me qira	5

Shoqëria është palë e një marrëveshje qiraje të nënshkruar që në tetor 2017 për ambientet e zyrave me një afat kontrate prej 5 vitesh, periudhë kjo që mund të zgjatet për një afat tjetër 5 vjecar nëse palët bien dakord nëpërmjet një marrëveshje me shkrim para perfundimit te afatit te kontrates. Shoqëria ka vlerësuar qe jetëgjatësia e aktivitetit te njohur “Punimet permiresuese te ambjentit te zyres me qira” te jete e bashkerenduar me kohezgjatjen e afatit qirase, dmth 5 vite, duke e amortizuar koston e ketyre permiresimeve ne baze lineare përgjatë 5 viteve.

Metodat e amortizimit, jetëgjatësitë dhe vlerat e rikuperueshme te aktivitetit rishikohen në fund të çdo viti financiar si dhe bëhen rregullime nëse është e përshtatshme.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.3 Qiratë (E drejta e përdorimit të aktivit me qira)**

Në fillimin e një kontrate, Shoqëria vlerëson nëse kontrata është, ose përmban, një qira që është objekt i njohjes të drejtës së përdorimit të aktivit. Një kontratë është, ose përmban, një qira nëse kontrata përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktiviteti të identifikuar për një periudhë kohe të caktuar, në këmbim të një pagese monetare.

Shoqëria zbaton një qasje të vetme njohjeje dhe matjeje për të gjitha qiratë, përveç qirave afatshkurtra dhe qiramarjes së aktiveve me vlerë të vogël. Shoqëria njihet detyrime qiraje për pagesat e qirasë që do të kryhen si dhe të drejtën e përdorimit, si aktiv, që përfaqëson të drejtën e përdorimit të aktivitetit të marre me qira.

#### ***E drejta e përdorimit të aktivitetit***

Shoqëria ka marre me qira ambientet për zyrën e saj. Shoqëria njihet të drejtën e përdorimit të aktivitetit në datën e fillimit të qirasë (d.m.th., data kur aktiviteti është i disponueshëm për përdorim). E drejta e përdorimit të aktivitetit maten me kosto, minus çdo amortizim të akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi, si dhe e rregulluar për çdo ri-matje të detyrimit të qirasë.

E drejta e përdorimit të aktivitetit matet me kosto që përfshin:

- shumën fillestare të matur të detyrimit të qirasë;
- çdo pagesë të bërë para apo në datën e fillimit të qirasë, minus çdo incentiv qiraje të marrë, dhe;
- kostot e nevojshme për të rikthyer aktivitetin në gjendjen e përcaktuar në kontratën e qirasë.

Kostot fillestare direkte për lidhjen e kontratës së qirase janë përjashtuar nga matja e të drejtës së përdorimit të aktivitetit në datën e zbatimit.

E drejta e përdorimit të aktiveve përgjithësisht amortizohet përgjatë periudhës më të shkurtër midis jetës së dobishme të aktivitetit dhe kohëzgjatjes së qirasë, duke përdorur metodën lineare të amortizimit. Nëse Shoqëria ka siguri të mjaftueshme që do të ushtrojë opsionin e blerjes, e drejta e përdorimit të aktivitetit do të amortizohet përgjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

Amortizimi i pjesëve të të drejtës së përdorimit të aktivitetit llogaritet duke përdorur metodën lineare mbi jetën e dobishme të përllogaritur. Jeta e dobishme e të drejtës së përdorimit të aktivitetit (ambientet e zyrës me qira) është 5 vjet.

Nëse pronësia e aktivitetit me qira transferohet të Shoqëria në fund të afatit të qirasë ose kostoja pasqyron ushtrimin e një opsioni blerjeje, amortizimi llogaritet duke përdorur jetëgjatësinë e vlerësuar të aktivitetit.

#### ***Detyrimet e qirasë***

Në datën e fillimit të qirasë, Shoqëria I njihet detyrimet e qirasë të matura me vlerën aktuale të pagesave që do të bëhen gjatë afatit të qirasë. Pagesat e qirasë përfshijnë pagesat fikse të qirase minus ndonjë incentive qiraje të përfituar, nëse ka, si dhe pagesat variable nëse ka, të cilat varen nga koeficientet dhe norma indeksimi, si dhe nga shumat për tu paguar në bazë të vlerave të mbetura sipas garancisë, nëse ka.

Pagesat e qirase përfshijnë gjithashtu vlerën e ushtrimit të opsionit të blerjes së aktivitetit nga qiramarrësi, kur ky opsion është mjaftueshmerisht i sigurt që do të ushtrohet, si dhe pagesat e penaliteteve për ndërprerjen e hershme të kontratës së qirase, nëse afati I qirase reflekton kushtin e ushtrimit të opsionit të ndërprerjes së kontratës nga Shoqëria.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.3 Qiratë (E drejta e përdorimit të aktivit) (vazhdim)**

##### **Detyrimet e qirasë (vazhdim)**

Ne llogaritjen e vlerës aktuale të pagesave të qirasë, Shoqëria përdor normën e saj të huamarrjes në datën e fillimit të qirasë sepse norma nominale e interesit në qira nuk është e përcaktuar. Pas datës së fillimit, shuma e detyrimeve të qirasë rritet për të reflektuar njohjen e interesit të llogaritur të pagueshem, si dhe zvogëlohet për pagesat e bëra të qirasë. Përveç kesaj, vlera kontabël e detyrimeve të qirasë ri-matet nëse ka ndonjë ndryshim në pagesat e qirase psh, ndryshim në afatin e qirasë, apo një ndryshim në cmimin e qirasë (p.sh., ndryshimet në pagesat e ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në normen e përcaktuar për indeksimin e cmimit të qirasë) apo një ndryshim në vlerësimin e opsionit të ushtrueshem për të blerë aktivin e marre me qira.

Pagesat e qirase jane skontuar duke perdorur normen e huamarrjes të udhëzuar nga Microsoft Corporation (Shoqëria Meme) norme e cila përfaqëson normën e interesit të huasë që Shoqëria do të paguante për fonde të marra hua të nevojshme për të siguruar një aktiv me vlerë të ngjashme me të drejtën e përdorimit të aktivit të marre me qira, në një mjedis të ngjashëm ekonomik me terma, kushte dhe garanci të ngjashme.

Shoqëria gjithashtu ka vlerësuar nese norma e skontimit të zbatuar duhet rregulluar për të reflektuar mjedisin ekonomik si dhe monedhen në të cilën maten transaksionet e qirase.

Microsoft Corporation (Shoqëria Meme) dhe filialet e saj, duke përfshirë Shoqërinë, janë pale të marrëveshjeve perkatëse të menaxhimit të centralizuar të qarkullimit të mjeteve monetare, ndërsa ketyre marrëveshjeve Shoqëria Meme rregullisht mban nga entitetet e saj bija, mjete monetare që u takojnë ketyre të fundit, për menaxhimin në mënyrë të centralizuar të qarkullimit të mjeteve monetare, dhe jua transferon keto mjete monetare entiteteve të saj bija, bazuar në nevojat e tyre operacionale për likuiditet. I gjithë financimi i borxhit gjithashtu menaxhohet në mënyrë të centralizuar nga Microsoft (d.m.th., filialet nuk marrin hua lokalisht në vendin ku operojnë). Prandaj, menaxhimi i Shoqërisë beson se nuk është i nevojshëm një rregullim i normës së zbatuar të skontimit për qëllim të pershtatjes së kesaj norme me kushtet e mjedisit ekonomik vendas.

#### **3.4 Instrumentat financiarë - njohja fillestare dhe matja e mëpasshme**

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një pasiv financiar ose një instrument kapitali të një njësie ekonomike tjetër.

##### **Aktivët Financiarë**

###### *Njohja dhe matja fillestare*

Aktivët financiarë klasifikohen, në njohjen fillestare, sipas kategorisë së matjes në instrumenta financiarë të matura me kosto të amortizuar, me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ) apo me vlerë të drejtë përmes fitim & humbjes. Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga karakteristikat kontraktuale të rrjedhës së parasë së instrumentit financiar dhe nga modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e aktiveve. Shoqëria fillimisht mat një instrument financiar me vlerën e tij të drejtë plus kostot e transaksionit, në rastin e një aktivi financiar jo me vlerë të drejtë përmes fitimit & humbjes.

Në mënyrë që një aktiv financiar të klasifikohet dhe matet me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë përmes ATGJ, ai duhet të krijojë flukse monetare që janë 'vetëm pagesa të principalit dhe interesit (SPPI)' mbi shumën kryesore të papaguar. Ky vlerësim referohet si testi SPPI dhe kryhet në një nivel instrumenti. Aktivët financiarë me flukse parash që nuk janë SPPI klasifikohen dhe maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, pavarësisht nga modeli i biznesit.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.4 Instrumentat financiare - njohja fillestare dhe matja e mëpasshme (vazhdim)**

##### **Aktivët Financiare (vazhdim)**

###### *Matja e mëpasshme*

Për qëllime të matjes së mëpasshme, aktivët financiarë klasifikohen në katër kategori:

- Aktive financiare me kosto të amortizuar (instrumente borxhi)
- Aktivët financiarë me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes
- Aktivët financiarë me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ) me fitim dhe humbjeve kumulative të ricikluara (instrumenta borxhi)
- Aktivët financiarë me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ) pa riciklim të fitimeve dhe humbjeve kumulative pas cregjistrimit (instrumentet e kapitalit)

Aktivët financiarë me kosto të amortizuar (instrumentet e borxhit), më pas maten duke përdorur metodën e interesit efektiv (EIR) dhe janë subjekt i zhvlerësimit. Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktivë çregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet.

###### *Metoda e normës së interesit efektiv*

Metoda e normës së interesit efektiv është një metodë për llogaritjen e koston të amortizuar të një detyrimi financiar dhe për alokimin e shpenzimit të interesit mbi periudhën përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma e cila skanton saktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuara përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, aty ku është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër.

Aktivët financiarë të Shoqërisë me kosto të amortizuar përfshijnë llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe mjete monetare dhe ekuivalentë të saj:

- Depozitat e parave të gatshme dhe ato afatshkurtra në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë paratë në bankë dhe depozitat afatshkurtra shumë likuide me një maturim prej tre muajsh ose më pak, të cilat janë lehtësisht të konvertueshme në parave të gatshme dhe janë objekt i një risku të papërfillshëm në ndryshimin e vlerës.
- Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv minus humbjet nga zhvlerësimi.

###### *Çregjistrimi i aktivitet financiar*

Një aktiv financiar çregjistrohet kryesisht kur të drejtat për të përfutur flukse parash nga aktivë kanë përfunduar, kur Shoqëria ka transferuar të drejtat e saj për të marrë flukse monetare nga aktivë, kur ka transferuar të drejtat për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivët financiarë ose ka hyrë në një marrëveshje likuidimi ndërkohë që (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiveve ose (ii) as nuk transferon dhe as nuk mban të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë por nuk ruan kontrollin e këtyre aktiveve.

###### *Zhvlerësimi*

Një aktiv financiar që nuk matet me vlerën e drejtë përmes fitimit/humbjes, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar zhvlerësim. Një aktiv financiar ka pësuar zhvlerësim nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në zhvlerësim të tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivitetit, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në flukset e ardhshme të parasë nga aktivë, të cilat mund të maten me besueshmëri.



### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.4 Instrumentat financiare (vazhdim)**

##### **Aktivt financiare (vazhdim)**

Humbja nga zhvlerësimi i aktivitet të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël neto dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv. Humbjet njihen në pasqyrën e fitim & humbjes dhe reflektohen në një llogari provigjoni qe eshte kunderparti e llogarive te arkëtueshme.

Interesi nga aktivet e zhvlerësuar vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shumat përkatëse rimerret nëpërmjet fitim ose humbjes.

##### **Detyrimet Financiare**

###### *Njohja dhe matja fillestare*

Detyrimet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, si detyrime financiare te matura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbje, kredi dhe hua, të pagueshme. Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe, në rastin e kredive dhe huave dhe të pagueshme, me vlere te drejte minus kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt.

Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë detyrimet tregtare dhe të tjera të pagueshme, kredi, huamarje dhe instrumenta derivative financiare.

###### *Matja e mëpasshme*

Për qëllime të matjes së mëpasshme, detyrimet financiare klasifikohen në dy kategori:

- Detyrimet financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes
- Detyrimet financiare me kosto të amortizuar (kreditë dhe huamarrjet).

Detyrimet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes përfshijnë detyrimet financiare të mbajtura për tregtim dhe detyrimet financiare të përcaktuara në njohjen fillestare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të mbajtura për tregtim nëse ato kryhen me qëllim të riblerjes në afatin më të afërt.

Detyrimet financiare përcaktohen në njohjen fillestare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes në datën fillestare të njohjes, vetëm nëse kriteret e SNRF 9 janë përmbushur. Shoqëria nuk ka përcaktuar ndonjë detyrim financiar me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

Pas njohjes fillestare, kreditë dhe huatë me interes maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normes efektive te interesit (NEI). Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje apo incentive në blerje si dhe tarifatat ose kostot që janë pjesë integrale e metodes NEI.

###### *Llogaritë e pagueshme*

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera të pagueshme deklarohen fillimisht me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar, duke përdorur metodën e normes efektive te interesit.

###### *Huamarrjet*

Huamarrjet fillimisht maten me vlerën e drejtë, minus kostot e transaksionit dhe më pas maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normes efektive te interesit, me shpenzimet e interesit të njohura në bazë të normës efektive të interesit.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.4 Instrumentat financiarë (vazhdim)**

##### *Çregjistrimi*

Një detyrim financiar çregjistrohet kur detyrimi përfundon ose anulohet. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet nga një tjetër nga i njëjti huadhënës në mënyrë thelbësore me kushte të ndryshme, ose kushtet e një detyrimi ekzistues janë modifikuar në mënyrë thelbësore, një shkëmbim i tillë ose një modifikim i tillë trajtohet si çregjistrim i detyrimit origjinal dhe njohje i një detyrim të ri. Diferenca në vlerat përkatëse kontabël njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

##### *Aktivitet jo-financiare*

Vlerat kontabël të aktiveve jo financiare të Shoqërisë rishikohen në datën e raportimit në mënyrë që të përcaktohet nëse ka ndonjë të dhënë për zhvleresimin e tyre. Nëse një e dhënë e tillë ekziston, në këtë rast vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme është më e madhja midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Për vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të parasë skontohehen me vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktivitetit për të cilin vlerësimet e flukseve të ardhshme të parasë nuk janë rregulluar.

Një humbje nga zhvleresimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi apo e njësisë të saj gjeneruese të parasë e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi njihen në humbje ose fitim.

#### **3.5 Njohja e të ardhurave**

##### *Të ardhurat e komisioneve prej kompanive të korporatës Microsoft*

Te ardhurat e komisioneve në baze të marrëveshjeve përkatëse midis entiteteve të Microsoft, përfaqëson një burim të brendshëm të ardhurash me të cilat korporata Microsoft shperblen filialet e saj vendore, përfshirë Shoqërinë, për aktivitetet që këto të fundit kryejnë për zhvillimit të tregut të produkteve të Microsoft global. Keto të ardhura njihen në baze të shpenzimeve operative të ndodhura nga filialet vendore. Qellimi i korporatës Microsoft është që duke i shperblyer filialet e saj vendore me të ardhurat e komisioneve, përveç të ardhurave që filialet vendore të Microsoft gjenerojnë nga kryerja e shërbimeve ndaj klienteve pale të treta, ato do të kenë një fitim të qëndrueshëm dhe do të sigurojnë një mbulim stabil të shpenzimeve të tyre operative.

##### *Të ardhurat nga kontratat me klientët*

Të ardhurat nga kontratat me klientët njihen kur kontrolli mbi mallrat apo shërbimet e furnizuara i transferohet klientit në një shumë që reflekton vlerën e arketueshme të cilën Shoqëria pret të perfitojë në këmbim të furnizimit të atyre mallrave apo shërbimeve. E ardhura matet me vlerën e drejtë të vlerës së arketueshme ose që priten të arkëtohet. E ardhura zvogëlohet me vlerën e perlllogaritur të kthimeve nga klientët, uljeve apo zbritjeve të tjera ngjashme, nëse ka.

Te ardhurat nga shërbimet profesionale të konsulencës Microsoft (MCS) dhe shërbimet mbështetëse Premier (PSS) të kryera ndaj klienteve palë të treta sipas kontratave përkatëse të shërbimeve, njihen në bazë të fazës së përfundimit të shërbimeve, e cila matet në bazë të orëve të punës së shpenzuara kundrejt totalit të oreve të planifikuara për realizimin e shërbimit.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.5 Njohja e të ardhurave (vazhdim)**

##### *Të ardhurat nga kontratat me klientët (vazhdim)*

Kompania njej të ardhurat bazuar në orët e punës të shpenzuara në raport me orët totale të pritshme të punës për të përfunduar shërbimin.

Kur shërbimet janë kryer nga një numër i pa-paracaktuar veprimesh përgjatë një peridhe të caktuar kohore, e ardhura njihet mbi bazë lineare përgjatë periudhës së specifikuar, për aq kohë sa nuk ka evidence se një metodë tjetër e përfaqëson më mirë fazën e përfundimit.

##### *Aktivitet kontraktuale*

Një aktiv kontraktual fillimisht njihet për të ardhurat e gjeneruara nga shërbimet ndaj klientëve sepse arketimi i vleres është e diktuar nga përfundimi i suksesshëm i shërbimeve. Pas përfundimit të shërbimeve dhe pranimit nga klienti, shumata e njohur si aktiv i kontratës riklasifikohet në llogari të arkëtueshme tregtare.

##### *Llogaritë e arkëtueshme tregtare*

Një llogari e arkëtueshme njihet nëse një vlerë e arkëtueshme që është e pakushtëzuar, pritet të paguhet nga klienti (d.m.th., është vetëm ceshtje kohe deri sa të realizohet arketimi i shumës). Zhvlerësimi i të arkëtueshmeve konstatohet kur ka evidencë objektive se Kompania nuk do të jetë në gjendje të arkëtojë të gjitha shumata e duhura sipas afateve origjinale të të arkëtueshmeve. Kostoja e amortizuar e afatshkurtër e të llogarive të arkëtueshme, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet për humbjet nga zhvlerësimi).

##### *Detyrimet kontraktuale*

Një detyrim kontraktual njihet nëse është pranuar një pagesë apo pritet të merret një pagesë nga një klient përpara se Shoqëria të transferojë (furnizojë) shërbimet përkatëse. Detyrimet kontraktuale njihen si të ardhura nga Shoqëria kur ajo realizon shërbimet sipas kontratës (d.m.th., transferon kontrollin e shërbimeve tek klienti).

#### **3.6 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi për llogaritë nëpër banka si dhe të ardhurat nga kurset e këmbimit, të cilat njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave. Të ardhurat nga interesi njihen në momentin që ato konstatohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Interesi periodik i konstatuar në aktivet financiare njihet në të ardhurat nga interesi.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesa mbi huatë dhe detyrimet mbi qiranë, si dhe humbjet nga kurset e këmbimit. Shpenzimet nga interesi njihen në momentin që ato konstatohen duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv. Interesi periodik i konstatuar në detyrimet financiare njihet në shpenzimet e interesit. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen në bazë neto.

#### **3.7 Të ardhurat dhe shpenzimet e tjera**

Të ardhurat dhe shpenzimet e tjera njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara në momentin që shërbimet janë kryer.

#### **3.8 Tatimi**

##### *Tatimi mbi fitimin*

Aktivi dhe detyrimi i tatimit mbi të ardhurat matet me shumën që pritet të rimbursohet nga apo të paguhet tek autoritetet tatimore. Normat tatimore dhe ligjet tatimore të përdorura për llogaritjen e shumës së tatimit fitimit janë ato që janë miratuar në datën e raportimit në vendin ku Shoqëria operon dhe gjeneron të ardhura të tatueshme.

Detyrimi për tatimi mbi të ardhurat që lidhet me zërat që njihen direkt në kapital dhe jo në pasqyrën e fitimit ose humbjes, njihet gjithashtu në kapital. Menaxhimi vlerëson në mënyrë periodike pozicionin e marrë nga Shoqëria në deklaratimet tatimore në lidhje me situatat në të cilat dispozitat e zbatueshme tatimore janë objekt i interpretimit dhe njej provigjione kur është e pershtatshme.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.8 Tatimi (vazhdim)**

##### *Tatimi i shtyrë*

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit dhe llogaritet si tatimi i pritshëm për t'u paguar ose për t'u arkëtuar në lidhje me diferencat e përkohshme që ekzistojnë midis balancave të aktiveve dhe detyrimeve të njohura për qëllime të kontabilitetit dhe vlerave perkatëse të përdorura për qëllime tatimore. Detyrimet për tatimin e shtyrë njihen për të gjithë diferencën e përkohshme të tatueshme, përveç:

- Kur detyrimi për tatimin e shtyrë lind nga njohja fillestare e emrit të mirë ose një aktivi/detyrimi në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi dhe, në kohën e transaksionit, nuk prek as fitimin kontabël dhe as fitimin ose humbjen e tatueshme.
- Kur diferencat e përkohshme të tatueshme të lidhura me investimet në filiale, apo në interesa në sipermarrje të përbashkëta, ku koha e rimarrjes së diferencave të përkohshme mund të kontrollohet dhe nuk është e mundur që diferencat e përkohshme të rimerren në një të ardhme të parashikueshme.

Aktivitet tatimore të shtyra njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme, humbjet tatimore të mbartura dhe të papërdorura. Aktivitet tatimore të shtyra njihen vetëm në masën që është e mundur që fitime të tatueshme të ardhshme do të jenë të disponueshme, kundrejt të cilave mund të zbriten diferencat e përkohshme të zbritshme dhe humbjet tatimore të mbartura dhe të papërdorura, përveç:

- Kur aktivi tatimor i shtyrë në lidhje me diferencën e përkohshme të zbritshme lind nga njohja fillestare e një aktivi ose detyrimi në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi dhe, në kohën e transaksionit, nuk prek as fitimin kontabël dhe as fitimin ose humbjen tatimore.
- Në lidhje me diferencat e përkohshme të zbritshme të lidhura me investimet në filiale, në sipermarrje të përbashkëta, aktivitet tatimore të shtyra njihen vetëm në masën që është e mundur që diferencat e përkohshme të rimerren në të ardhmen dhe të ekzistojnë një fitim tatimor i mjaftueshëm i ardhshëm mbi të cilin mund të shfrytëzohen diferencat e zbritshme.

Vlera kontabël e aktivitetit të tatimit të shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet deri në atë masë sa nuk është më e mundur që fitimi i tatueshëm do të jetë i disponueshëm për të lejuar që të shfrytëzohet e gjitha ose një pjesë e aktivitetit të tatimit të shtyrë.

Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra maten me normat e taksave që pritet të zbatohen në vitin kur aktivi është realizuar ose detyrimi është shlyer, bazuar në normat e taksave (dhe ligjet tatimore) që janë miratuar në datën e raportimit

#### **3.9 Provigjionet**

Provigjionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, është e mundur që një rrjedhje e burimeve që kanë përfitime ekonomike do të kërkojë për të shlyer detyrimin dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit. Kur Shoqëria pret që disa ose të gjitha provigjionet të rimbursohen, për shembull, nën një kontratë sigurimi, rimbursimi njihet si një aktiv i veçantë, por vetëm kur rimbursimi është praktikisht i sigurt. Shpenzimi në lidhje me një provigjion paraqitet në pasqyrën e fitimit ose humbjes minus shumën e të ndonjë rimbursimi.

#### **4. APLIKIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË PËRDITËSUARA**

##### **4.1 STANDARDET E PUBLIKUAR, POR, ENDE JO EFEKTIVE**

Standardet dhe interpretimet e publikuar, por ende jo efektive, deri në datën e nxjerrjes së pasqyrave financiare të Shoqërisë janë dhënë më poshtë. Shoqëria synon të miratojë këto standarde, nëse është e aplikueshme, kur ato te hyjnë në fuqi.

- **Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare: Klasifikimi i Detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata (Ndryshimet)**

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më 1 janar 2024 ose pas kësaj date, me aplikim më të hershëm të lejuar dhe do të duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8. Objektivi i ndryshimeve është të qartësojë parimet në SNK 1 për klasifikimin e detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata. Ndryshimet sqarojnë kuptimin e një të drejte për të shtyrë shlyerjen, kushtet që kjo e drejtë të ekzistojë në fund të periudhës raportuese, që synimi i drejtimit është të mos ndikojë në klasifikimin afatshkurter apo afatgjatë, që opsionet e ndermarre nga pala tjetër në marreveshje që mund të rezultojnë në shlyerjen e detyrimit nëpërmjet transferimit të instrumenteve të kapitalit të vet të njësisë ekonomike nuk ndikojnë në klasifikimin afatshkurter ose afatgjatë. Gjithashtu, ndryshimet specifikojnë që vetëm dispozitat kushtpercaktuese me të cilat një njësi ekonomike raportuese duhet të jete në përputhshmeri në ose përpara datës së raportimit janë ato që do ndikojnë në klasifikimin e një detyrimi në afatshkurter apo afatgjatë. Gjithashtu kërkohen dhënie informacionesh shpjeguese shtesë për detyrimet afatgjata që rrjedhin nga marrëveshjet e huave që kanë dispozita kushtpercaktuese që duhet të respektohen brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit. Ndryshimet nuk janë miratuar ende nga BE.

- **Ndryshime në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare dhe Deklarata e Praktikës IFRS 2: Shpalosja e politikave kontabël.**

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2023 ose pas kësaj date me aplikim të mëhershëm të lejuar. Ndryshimet ofrojnë udhëzime për zbatimin e gjykimeve për zbatimin e vlerësimeve të materialitetit në dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël. Në veçanti, ndryshimet në SNK 1 zëvendësojnë kërkesën për të shpalosur politikat kontabël 'të rëndësishme' me një kërkesë për të shpalosur politikat kontabël 'materiale'. Gjithashtu, udhëzues dhe shembuj ilustrues shtohen në deklaratën e praktikave shembuj që ndihmojnë në zbatimin e konceptit të materialitetit kur bëhen gjykime në lidhje me dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël.

- **Ndryshimet në SNK 8 politikat kontabël, Ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet kontabël: Përkufizimi i vlerësimeve kontabël**

Ndryshimet hyjnë në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023 me aplikimin më të hershëm të lejuar dhe zbatohen për ndryshimet në politikat kontabël dhe ndryshimet në vlerësimet kontabël që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe. Ndryshimet prezantojnë një përkufizim të ri të vlerësimeve kontabël, të përcaktuara si vlera monetare në pasqyrat financiare që janë subjekt i pasigurisë në matje, nëse ato nuk kanë rezultuar nga korrigjimi I një gabimi kontabël në një periudhe të kaluar. Gjithashtu, ndryshimet sqarojnë se cilat janë ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe si ndryshojnë këto nga ndryshimet në politikat kontabël dhe korrigjimet e gabimeve. Ndryshimet nuk janë miratuar ende nga BE. Shoqëria nuk pret ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat e saj financiare.



#### **4. APLIKIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË PËRDITËSUARA (VAZHDIM)**

##### **4.1 STANDARDET E PUBLIKUARA, POR, ENDE JO EFEKTIVE (VAZHDIM)**

- **Ndryshime në SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat: Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm.**

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2023 ose pas kësaj date, me aplikim të mëhershëm të lejuar. Ndryshimet kufizojnë zbatimin dhe japin qartësi të mëtejshme për përjashtimin e njohjes fillestare sipas SNK 12 dhe specifikojnë se si kompanitë duhet të llogarisin për tatimin e shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm, të tilla si qiratë dhe detyrimet e nxjerrjes jashtë përdorimit. Ndryshimet sqarojnë se kur pagesat që shlyejnë një detyrim janë të zbritshme për qëllime tatimore, është çështje gjykimi duke pasur parasysh ligjin tatimor në fuqi, nëse këto zbritje i atribuohen për qëllime tatimore detyrimit ose elementit të aktivitetit përkatës. Sipas ndryshimeve, përjashtimi në njohjen fillestare nuk zbatohet për transaksionet që, në njohjen fillestare, krijojnë diferenca të përkohshme të barabarta të tatueshme dhe të zbritshme. Ai zbatohet vetëm nëse njohja e një aktivi të qirase dhe detyrimi të qirasë (ose detyrimi dhe aktivi në perfundim të kontrates së qirase) sjellin diferenca të përkohshme të tatueshme dhe të zbritshme që nuk janë të barabarta.

- **Ndryshimet në SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe SNK 28 Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta: Shitja ose kontributi në aktive midis një investitori dhe palës tjetër në një sipërmarrje të përbashkët.**

Ndryshimet trajtojnë një mospërputhje ekzistuese të pranuar midis kërkesave në SNRF 10 dhe atyre në SNK 28, në trajtimin e shitjes ose kontributit të aktiveve ndërmjet një investitori dhe palës tjetër në një sipërmarrje të përbashkët.

Pasojat kryesore të ndryshimeve është se një fitim ose humbje e plotë njihet kur një transaksion përfshin një biznes (nëse ajo është pjesë e kompanisë së filialit ose jo). Një fitim ose humbje e pjesshme njihet kur një transaksion përfshin aktive që nuk përbëjnë një biznes, edhe nëse këto aktive janë të vendosura në një filial. Në dhjetor 2015, BSNK shtyu datën e hyrjes në fuqi të këtij ndryshimi për një kohë të pacaktuar në pritje të rezultetit të projektit të saj kërkimor mbi metodën e kapitalit neto të kontabilitetit. Ndryshimet nuk janë miratuar ende nga BE. Shoqëria nuk pret ndonjë ndikim në pasqyrat e saj financiare.

##### **4.2 STANDARDET E PUBLIKUARA QË JANË TË ZBATUESHME PËR PERIUDHËN**

Standardet e mëposhtme të ndryshuara u bënë efektive nga 1 Janari 2022, por nuk patën ndonjë ndikim në Shoqëri:

***Ndryshimet në SNRF 3 Kombinimet e Biznesit; SNK 16 Aktivet afatgjata materiale, makinerite dhe pajisjet; SNK 37 Provizionet, Detyrimet dhe Aktivet e kushtezuara si dhe përmirësimet vjetore 2018-2020 (ndryshimet).*** Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2022 ose pas kësaj date me aplikim të mëhershëm të lejuar. BSNK ka nxjerrë ndryshime me zbatim të kufizuar në Standardet SNRF si më poshtë:

- ***Ndryshimet në SNRF 3-Kombinimet e Biznesit,*** përditësojnë një referencë në SNRF 3 në versionin e mëparshëm të Kuadrit Konceptual të BSNK-së për Raportimin Financiar në versionin aktual të lëshuar në 2018 pa ndryshuar ndjeshëm kërkesat e kontabilitetit për kombinimet e biznesit.
- ***Ndryshimet në SNK 16 Aktivet afatgjata materiale*** ndalon një kompani që të zbrisë nga kostoja e aktiveve afatgjata materiale çdo të ardhur nga shitja e artikujve të prodhuar ndërkohë që e sjell aktivin në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë në gjendje të operojë në mënyrën e synuar nga drejtimi. Në vend të kësaj, një kompani njihet të ardhurat e tilla nga shitjet dhe kostot përkatëse në fitim ose humbje.

#### **4.2 STANDARDET E PUBLIKUARA QË JANË TË ZBATUESHME PËR PERIUDHËN (vazhdim)**

- ***Ndryshimet në SNK 37 Provizionet, Detyrimet dhe Aktivet e Kushtëzuara (ndryshimet)*** specifikon se cilat kosto përfshin një kompani në përcaktimin e kostos për përmbushjen e një kontrate me qëllimin e vlerësimit nëse një kontratë është humbëse apo jo. Ndryshimet sqarojnë se kostot që lidhen drejtpërdrejt me një kontratë për ofrimin e mallrave dhe shërbimeve përfshijnë si kostot direkte që varen nga volume I prodhimit ashtu edhe kostot e alokuara që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontrates.
- ***Përmirësimet vjetore 2018-2020*** bëjnë ndryshime të vogla në ***SNRF 1 Zbatimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, SNRF 9 Instrumentet Financiare, SNK 41 Bujqësia*** dhe shembujt ilustrues që shoqërojnë qiratë.
- ***Ndryshimet në SNRF 16 Qiratë-Covid 19 Koncesionet e Qirasë përtej datës 30 Qershor 2021.*** Ndryshimet zbatohen për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë nga 1 Prill 2021 ose pas kësaj date, me aplikim të mëhershëm të lejuar, duke përfshirë në pasqyrat financiare të paautorizuara ende për publikim në datën e lëshimit të ndryshimit. Në mars 2021, Bordi ndryshoi kushtet e lehtësimit praktik në SNRF 16 që ofron lehtësim për qiramarrësit për zbatimin e udhëzimit të SNRF 16 për kontabilitetin e modifikimeve të qirasë për lehtësimet mbi detyrimet e qirasë që lindin si pasojë e drejtpërdrejtë e vështirësive ekonomike nga pandemia e Covid-19. Pas ndryshimit në fjale, lehtësimi praktik në zbatim tani aplikohet për lehtësimet në detyrimet e qirasë, për të cilat çdo ulje në pagesat e qirasë prek vetëm pagesat që duhet të paguhet para ose deri me datën 30 qershor 2022, me kusht që kushtet e tjera për lehtësimin praktik të zbatimit të jete të përmbushura.



## 5. PËRCAKTIMI I VLERËS SË DREJTË

### Matja e vlerës së drejtë

Shoqëria mat instrumentat financiarë si derivativët dhe aktivet jo-financiare të tilla si investimet ne prona, nëse ka, me vlerën e drejtë në çdo datë të bilancit. Vlera e drejtë është çmimi që do të merrej për të shitur një aktiv ose do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Matja e vlerës së drejtë bazohet me supozimin se transaksioni për të shitur aktivin ose transferuar detyrimin bëhet:

- Në një treg kryesor të aktivit apo detyrimit, ose
- Në mungesë të një tregu kryesor, në tregun më të favorshëm për aktivin ose detyrimin.

Tregu kryesor ose tregu më i favorshëm duhet të jetë i arritshëm nga Shoqëria.

Vlera e drejtë e një aktivi ose një detyrimi matet duke përdorur supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të përdorin kur vendosin çmimin e aktivit apo te detyrimit, duke supozuar që pjesëmarrësit e tregut veprojnë në interesin më të mirë ekonomik të tyre.

Një matje e vlerës së drejtë të një aktivi jo-financiar merr parasysh aftësinë e një pjesëmarrësi të tregut për të gjeneruar përfitime ekonomike duke përdorur aktivin në mënyrën më të mirë ose duke e shitur atë te një pjesëmarrës tjetër i tregut që do ta përdorte aktivin në mënyrën më të mirë.

Shoqëria përdor teknika vlerësimi që janë të përshtatshme në rrethanat dhe për të cilat ka të dhëna të mjaftueshme për të matur vlerën e drejtë, duke maksimizuar përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe duke minimizuar përdorimin e inputeve të pavëzhgueshme.

Të gjitha aktivet dhe detyrimet për të cilat vlera e drejtë matet ose paraqitet në pasqyrat financiare janë të kategorizuara brenda hierarkisë së vlerës së drejtë, të përshkruar si më poshtë, bazuar në nivelin me të ulët të inputit që është domethënës në matjen e vlerës së drejtë në tërësi:

**(a) Niveli 1:** Cmimet e tregut të kuotuar (të parregulluara), në tregjet aktive për aktive ose detyrime identikisht të njëjta.

**(b) Niveli 2:** Teknikat e vlerësimit, për të cilat niveli më i ulët i të hyrave që është i rëndësishëm në matjen e vlerës së drejtë është në mënyrë direkte ose indirekte i vëzhgueshëm.

**(c) Niveli 3:** Teknikat e vlerësimit, për të cilat niveli më i ulët i të hyrave që është i rëndësishëm në matjen e vlerës së drejtë është në mënyrë direkte ose indirekte i pavëzhgueshëm.

Shoqëria ka vetëm nivelin 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare jo-derivative (e cila përcaktohet vetëm për qëllime të paraqitjes) dhe vlera e drejtë nuk devijon nga vlerat e tyre kontabël.

## 6. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

	Pajisje zyre	Mobilje dhe orendi zyre	Punime e riparime për ambientet me qira	Totali
<b>Kosto historike</b>				
<b>Gjendja më 1 Janar 2021</b>	<b>9,871</b>	<b>5,859</b>	<b>16,735</b>	<b>32,465</b>
Shtesa	-	-	-	-
Pakësime	(494)	(64)	-	(559)
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2021</b>	<b>9,377</b>	<b>5,795</b>	<b>16,735</b>	<b>31,906</b>
Shtesa	-	-	-	-
Pakësime	(2,838)	(5,795)	-	(8,632)
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2022</b>	<b>6,539</b>	<b>-</b>	<b>16,735</b>	<b>23,274</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>				
<b>Gjendja më 1 Janar 2021</b>	<b>(9,757)</b>	<b>(5,763)</b>	<b>(9,676)</b>	<b>(25,195)</b>
Amortizimi i vitit	(114)	(96)	(3,347)	(3,557)
Pakësime	494	64	-	559
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2021</b>	<b>(9,377)</b>	<b>(5,795)</b>	<b>(13,023)</b>	<b>(28,194)</b>
Amortizimi i vitit	-	-	(3,347)	(3,347)
Pakësime	2,838	5,795	-	8,633
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2022</b>	<b>(6,539)</b>	<b>-</b>	<b>(16,370)</b>	<b>(22,908)</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>				
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2021</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>3,712</b>	<b>3,712</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2022</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>365</b>	<b>365</b>

Disa artikuj nga kategoria "mobiljet e zyrës" dhe "pajisje zyre" artikuj me vlerë neto kontabel zero (qe nga celja e periudhës aktuale) janë dhuruar nga Shoqeria gjate vitit 2022, dhe ne kete menyre janë hequr nga inventari. Kostoja e amortizuar teresisht e artikujve të dhuruar ka qene 8,633 mijë Lek.

Asnjë aktiv nuk eshte lënë peng si kolateral deri më 31 dhjetor 2022 (31 dhjetor 2021: asnjë).

**7. E DREJTA E PËRDORIMIT TË AKTIVEVE**

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
E drejta e përdorimit të aktivitetit me qira	22,296	22,361
Rimatje e te drejtes së përdorimit të aktiveve	-	(65)
E drejta e përdorimit të aktivitetit me qira e njohur nga modifikimi i kontratës	2,275	-
Amortizimi i akumuluar	(23,430)	(18,970)
<b>Vlera kontabël neto</b>	<b>1,141</b>	<b>3,326</b>

E drejta e përdorimit të aktivitetit me qira është njohur sipas dispozitave të SNRF 16 në lidhje me qiranë e zyrës për afatin e plotë të qirasë (1 tetor 2017 deri më 30 shtator 2022). Amortizimi i akumuluar përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur nga data fillestare e zbatimit të standartit.

Në periudhën aktuale të raportimit, kontrata e qirasë ka përfunduar më 30 Shtator 2022, kështu që aktivi dhe detyrimi i qerasë i njohur në lidhje me qiranë origjinale të zyrës (shtator 2017 - shtator 2022) janë amortizuar dhe shlyer në përputhje me kontratën.

Po kështu në periudhën aktuale, Shoqëria ka njohur një të drejtë të re përdorimi të aktivitetit dhe një detyrim të ri të qeraje në lidhje me zgjatjen e re të kontratës së qirase, përtej afatit të kontratës fillestare. Zgjatja e kontratës u ra dakort për 6 muaj (nga 1 Tetor 2022 deri në 31 Mars 2023). Bazuar në udhëzimet e SNRF16, ky ndryshim është njohur kontabilisht si një kontratë qiraje e veçantë.

Detaje të mëtejshme mbi njohjen fillestare, matjen dhe amortizimin e të drejtës së përdorimit të aktivitetit janë dhënë në shënimin shpjegues nr. 24 të këtyre Pasqyrave Financiare.

**8. AKTIVET TATIMORE TË SHTYRA**

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Aktiv tatimor i shtyre I njohur mbi diferencën e perkohshme të zbritshme midis vlerës kontabel dhe tatimore të te drejtes së përdorimit të aktivitetit me qira të zyrës	50	47
Aktiv tatimor i shtyre i njohur mbi diferencën e perkohshme të zbritshme midis vlerës kontabel dhe tatimore të amortizueshme të aktiveve afatgjata	446	1,163
<b>Totali</b>	<b>497</b>	<b>1,210</b>

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
<b>Levizjet vjetore në aktivet tatimore të shtyra</b>	<b>Aktiv / (detyrim) neto</b>	<b>Aktiv / (detyrim) neto</b>
<b>Gjendja në fillim të vitit</b>	<b>1,211</b>	<b>1,104</b>
<b>Njohur në fitim / humbje (shënimi 24)</b>	<b>(714)</b>	<b>107</b>
<i>Aktivitet tatimore të shtyra nga bonuset</i>	-	13
<i>Aktivitet tatimore të shtyra nga aktivet afatgjata</i>	(718)	64
<i>Aktivitet tatimore të shtyra nga e drejta e përdorimit të aktivitetit me qirase të zyrës</i>	4	30
<b>Gjendja në fund të vitit</b>	<b>497</b>	<b>1,210</b>

**9. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË PERIUDHAVE TE ARDHME**

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Garanci për qirane e zyres	1,600	1,600
Parapagime furnitorëve	2	2
	<u>1,602</u>	<u>1,602</u>

Garancia për qiranë e zyrave është dhënë në përputhje me kontratën në fuqi. Parapagimet e kryera ndaj furnitorëve janë për shërbime që do të maturohen në periudhën e pasardhese.

**10. LLOGARITE E ARKETUESHME TREGTARE DHE TË TJERA**

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Llogari të arkëtueshme nga kompani te grupit per komisionet (Microsoft Global Finance)	39,415	41,317
Llogari të arkëtueshme nga klientë në lidhje me shërbimet profesionale te konsulences Microsoft (MCS) dhe premier (PSS)	93,356	19,248
Të ardhura të llogaritura për shërbimet profesionale të konsulencës MCS	5,475	-
Aktive te tjera tatimore	223	223
<b>Totali</b>	<u>138,469</u>	<u>60,788</u>

Balanca e llogarise se arkëtueshme nga kompani te grupit Microsoft përbëhet nga të arkëtueshmet në lidhje me të ardhurat e faturuara nga komisionet, të cilat përfaqësojnë një burim të brendshëm të ardhurave me të cilat Microsoft Corporation shperblen filialet vendore te Microsoft per aktivitetet per zhvillimit te tregut qe keto te fundit kryejne per te njohur tregun vendas me produktet dhe shërbimet e Microsoft Corporation. Te ardhurat nga komisionet llogariten në bazë të metodës së kostos neto plus, pra duke zbritur nga vlera bruto e shpenzimeve operacionale totale të kryera nga Shoqëria (norma e indeksimit të shpenzimeve operacionale është pikërisht norma e marzhit të mbulimit të këtyre shpenzimeve), duke zbritur të ardhurat nga shërbimet e kryera ndaj klientëve pale të treta. Balanca e arkëtueshme nga Microsoft Corporation do të arkëtohet kur Microsoft Albania të përballet me vështirësi likuiditeti.

Zëri I të ardhurave të llogaritura për shërbimet profesionale të konsulencës MCS përfaqëson shumën e të ardhurave të njohura nga Shoqëria në periudhën aktuale për shërbimet e kryera ndaj klientëve pale të treta, për të cilën fatura tatimore do të lëshohet në periudhën pasuese.

Referuar të ardhurave të llogaritura për shërbimet profesionale të konsulencës MCS, janë aprovuar në vitin 2023, dhe janë arkëtuar në 27 mars 2023.

**11. PARAJA DHE EKUIVALENTET E SAJ**

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
<b>Para në bankë</b>		
Llogari rrjedhëse në LEK	151,696	84,293
Llogari rrjedhëse në USD	2,533	2,734
<b>Totali</b>	<u>154,229</u>	<u>87,027</u>

**12. KAPITALI AKSIONAR**

	Më 31 dhjetor 2022		Më 31 dhjetor 2021	
	Numri i kuotave	LEK	Numri i kuotave	LEK
Microsoft Corporation	100	100	100	100
	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>

Shoqëria është regjistruar në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në 30 qershor 2008 me NIPT K81830011C, me kapital të paguar prej 100 mijë LEK i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale 1,000 Lek secila. Microsoft Corporation zotëron 100% të kuotave.

**13. Detyrimi i Qirase**

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Detyrimi i Qirasë		
<i>Pjesa e detyrimit afatshkurtër të qirasë</i>	1,121	3,465
<i>Pjesa e detyrimit afatgjatë të qirasë</i>	-	-
<b>Totali</b>	<b>1,121</b>	<b>3,465</b>

Detyrimi i qirasë së bashku me të drejtën e përdorimit të aktivitetit të qirase se zyres te raportuar në shënimin shpjegues nr. 7 te Pasqyrave Financiare, lidhen me qiranë e zyrës dhe jane njohur në përputhje me kërkesat e SNRF 16. Detyrimi i qirasë përfaqëson vlerën kontabël të njohur te pagesave te ardhshme te qirase në njohjen fillestare, të zvogëluar me pagesat e principalit të qirasë te kryera si dhe te rritur me vlerën e interesit të llogaritur dhe paguar deri më tani. Detaje të mëtejshme mbi njohjen fillestare dhe matjen e detyrimit të qirasë jepen në shënimin shpjegues nr.24 të Pasqyrave Financiare.

**14. DETYRIME KONTRAKTUALE**

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Detyrime kontraktuale	10,882	11,524
<b>Totali</b>	<b>10,882</b>	<b>11,524</b>

Detyrimet kontraktuale përfaqësojnë të ardhurat që do njihen ne periudhën në vijim për pagesat e arketuara në avancë nga kliente per shërbime te porositura qe do kryhen bazuar në kontratat respektive te shërbimeve.

**15. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE DHE TË TJERA**

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
TVH e pagueshme	15,253	2,306
Shpenzime të përllogaritura	376	3,255
Detyrime ndaj furnitorëve	330	1,768
Sigurime shoqërore	32	27
Tatimi mbi të ardhurat personale	14	18
<b>Totali</b>	<b>16,005</b>	<b>7,394</b>

Varianca më e lartë në llogaritë e të pagueshmeve vjen prej TVSH së pagueshme. Ky vit solli një rritje të TVSH së pagueshme si rrjedhojë e totalit të shitjeve në 2022, si dhe rezultatit pozitiv në fund të vitit të Kompanisë.

Shpenzimet e llogaritura në periudhën aktuale konsistojnë në kostot e njohura nga shërbimet e marra nga furnitorët vendas, për nevojat e funksionimit të zyrës dhe shërbimet e konsulences, për të cilat furnitorët do të lëshojnë faturat në janar të vitit pasues.

**16. DETYRIMET TATIMORE**

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Tatim fitimi i pagueshëm	10,897	2,112
<b>Totali</b>	<b>10,897</b>	<b>2,112</b>

**17. TË ARDHURAT**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura nga shërbimet profesionale MCS/PSS	229,670	108,920
Të ardhura nga komisionet	-	(1,703)
<b>Totali</b>	<b>229,670</b>	<b>107,217</b>

Të ardhurat nga shërbimet janë njohur nga shërbimet profesionale Microsoft (MCS) si dhe shërbimet për mbështetje teknike (PSS) të kryera gjatë periudhës, ndaj klienteve vendore pale të treta.

Të ardhura nga komisionet përfaqësojnë një burim të brendshëm të ardhurave që Microsoft Corporation shperblen filialet vendore të Microsoft për aktivitetet e zhvillimit të tregut që këto të fundit kryejnë në lidhje me produktet dhe shërbimet e Microsoft Corporation. Të ardhurat nga komisionet llogariten në bazë të metodës së kostos neto plus, pra duke zbritur nga vlera bruto e shpenzimeve operacionale totale të kryera (norma e indeksimit të shpenzimeve operacionale është pikerisht norma e marzhit të mbulimit të ketyre shpenzimeve), të ardhurat nga shërbimet e kryera ndaj klienteve pale të treta.

**18. SHPENZIME PERSONELI**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Paga dhe shtesa të tjera nga punësimi	(1,906)	(2,394)
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	(250)	(292)
<b>Totali</b>	<b>(2,157)</b>	<b>(2,686)</b>

**19. SHPENZIME OPERATIVE TË TJERA**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shërbime të nënkontraktuara (MCS + Premier)	(7,551)	(8,810)
Shpenzime mirëmbajtje	(784)	(880)
Shpenzime publiciteti	(643)	-
Internet	(559)	(766)
Shërbime ligjore dhe konsulence profesionale	(276)	(236)
Shërbime konsulence të tjera	(257)	-
Blerje materiale për zyren	(237)	(104)
Shërbime bankare	(97)	(101)
Shpenzime pritje	(39)	(76)
Gjoha	(10)	(10)
Shërbime postare	(2)	(21)
Shpenzime siguracionesh	-	(7)
Telefon	-	2
Shpenzime të tjera	(296)	(4,335)
<b>Totali</b>	<b>(10,751)</b>	<b>(15,344)</b>

Shërbime të nënkontraktuara përfaqësojnë kryesisht shërbime profesionale teknike (MCS) të marra nga furnitore pale të treta. Shpenzimet e përlloritura kanë të bëjnë me koston e njohur të shërbimeve të marra por ende të pafaturura nga ofruesit e shërbimeve. Shpenzime të tjera përfaqësojnë taksat vendore, pagesa e tarifave për nenshkrimit elektronik. Shpenzimet e mirëmbajtjes lidhen me shpenzimet e përbashkëta të mirëmbajtjes së ndërtesës së zyres. Shpenzimet e publicitetit përfaqësojnë shërbime profesionale nga furnitore palë të treta që reklamojnë në mediat elektronike lokale produktet dhe shërbimet globale të Microsoft.

**20. SHPENZIME INTERESI**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shpenzime Financiare	(43)	(134)
<b>Totali</b>	<b>(43)</b>	<b>(134)</b>

Shpenzimet financiare paraqesin pjesën e interesit të llogaritur mbi detyrimin e njohur nga kontrata e qirasë së zyres, sipas kërkesave të SNRF 16, e cila është përlloritur dhe paguar për periudhën aktuale.

**21. (HUMBJA) /FITIMI NGA KURSI I KËMBIMIT, NETO**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Humbje nga kursi i këmbimit	(3,135)	(736)
Fitimi nga kursi i këmbimit	522	195
<b>Totali</b>	<b>(2,613)</b>	<b>(542)</b>

**22. SHPENZIMI I TATIM MBI FITIMIN**

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin për vitet e mbyllura respektivisht me 31 dhjetor 2022 dhe 2021 është i përbërë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shpenzimi per detyrimin korent te tatim fitimit ne masen 15% (per v. 2021: 15%) (përfshirë efektin e diferencave të përhershme)	(31,572)	(12,777)
Shpenzimi / e ardhura nga tatimi i shtyrë: Lindja dhe rimarrja e diferencave te perkohshme (te tatueshme) / te zbritshme. (diferenca midis balancave mbyllesë, ne shenimin nr. 8, eshte njohur ne fitim / humbje)	(714)	107
<b>Shpenzimi total i tatim fitimit</b>	<b>(32,286)</b>	<b>(12,670)</b>

Norma standarde e detyrimit te tatimit fitimit për vitin është 15% (2021: 15%); Shpenzimi I tatim fitimit për vitin mund të rakordohet me fitimin kontabël si në vijim:

	Norma efektive e tatimit	2022	Norma efektive e tatimit	2021
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>206,514</b>		<b>80,727</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	15%	(30,977)	15%	(12,109)
<i>Efekti tatimor i:</i>				
Shpenzimeve te pazbritshme (sipas deklarates se TF)	-0.29%	(595)	-1.17%	(946)
Shpenzime te zbritshme (diferenca te perhershme nga rimarrja e provigjioneve)	0.00%	-	0.34%	278
Te ardhura nga detyrime tatimore te shtyra (diferenca te perkohshme te tatueshme)	-0.35%	(714)	0.13%	107
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin i njohur ne fitim / humbjen e vitit</b>	<b>15.63%</b>	<b>(32,286)</b>	<b>15.69%</b>	<b>(12,670)</b>

E ardhura apo shpenzimi tatimor i shtyrë (difference e perkoheshme e tatueshem/e zbritshme) është njohur si rezultat i diferencave të përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve/detyrimeve dhe bazës së tyre tatimore, përkatësisht per aktivet afatgjata materiale si dhe te drejten e perdorimit te aktivitetit te qirasë të njohur sipas SNRF 16.

Shpenzimet e pazbritshme (diferencat e perhershme) përfaqesojne shpenzime biznesore të cilat nuk janë të mbështetura me dokumentacion të rregullt fiskal, si dhe penalitete tatimore dhe shpenzime të tjera që nuk njihen per qellim te tatim fitimit, të cilat janë të pazbritshme nga natyra (duke përberë diferencat e perhershme të shpenzimeve të pazbritshme).

**23. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA**

Transaksionet me palët e lidhura më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqiten si më poshtë

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
<i>Llogari të arkëtueshme:</i>		
Microsoft Global Finance	39,415	41,317
<b>Total</b>	<b>39,415</b>	<b>41,317</b>



**23. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA (vazhdim)**

Transaksionet me palët e lidhura më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqiten si më poshtë

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
<i>Të ardhurat e llogaritura nga komisionet</i>		
Microsoft Global Finance	-	(1,703)
<b>Total</b>	<b>-</b>	<b>(1,703)</b>

**24. SNRF 16 "Qiratë"**

Shoqëria është palë e një kontrate qiraje, për qirane të zyrës në Tiranë, e cila i është nënshtruar zbatimit të SNRF 16.

Siç është shpjeguar edhe në shënimin 7 "E Drejta e përdorimit të aktivitetit", në periudhën aktuale të raportimit, afati fillestar i kontratës së qirase së zyrës përfundoi efektivisht më 30 shtator 2022, kështu që aktivi dhe detyrimi i njohur në lidhje me kontratën e qirase së zyrës (periudha e kontratës shtator 2017 - shtator 2022) është amortizuar dhe shlyer respektivisht sipas kontratës.

Në periudhën aktuale të raportimit, Shoqëria ka njohur një të drejtë të re të përdorimit të aktivitetit dhe detyrim të ri për qirane në lidhje me zgjatjen prej 6 muajsh të kontratës së qirase së zyrës, të dakort midis Shoqërisë dhe qiradhenesit, Gener 2 shpk, sipas marrëveshjes me numër 091017-OLA-1205 (zgjatja e afatit është nga 1 Tetor 2022 deri në 31 Mars 2023). Bazuar në udhëzimet e SNRF 16 ky ndryshim është trajtuar si modifikim dhe është kontabilizuar si qira e vecantë.

Efektet e njohjes së aktivitetit, detyrimit nga ndryshimi në kontratën e qirase, në pasqyrën e pozicionit financiar si dhe në pasqyrën e fitim / humbjes, në përputhje me dispozitat e SNRF 16, paraqiten më poshtë:

**Pasqyra e Pozicionit Financiar**

	<b>31/12/2022</b>	<b>31/12/2021</b>
<b>E drejta e përdorimit të aktivitetit (kontrata fillestare)</b>	<b>22,296</b>	<b>22,361</b>
Rimatje e të drejtës së përdorimit të aktivitetit	-	(65)
E drejta e përdorimit të aktivitetit nga modifikimi i kontratës i kontabilizuar si qira e vecantë	2,275	-
Amortizimi i akumuluar	(23,430)	(18,970)
<b>Total e të drejtës së përdorimit të aktivitetit</b>	<b>1,141</b>	<b>3,326</b>

Vlerat kontabel të detyrimit të qirase të njohur sipas SNRF16, dhe levizjet e detyrimit të qirase gjatë periudhës, janë paraqitur më poshtë:

	<b>31/12/2022</b>	<b>31/12/2021</b>
<b>Detyrimi i qirase në fillim të vitit (kontrata fillestare)</b>	<b>3,465</b>	<b>8,191</b>
Rimatja e detyrimit	-	(61)
Detyrim i ri i qirasë (modifikimi i qirasë si qira e vecantë)	2,275	-
<b>Pagesat e detyrimit të qirase</b>	<b>(4,625)</b>	<b>(4,664)</b>
<i>Principali i paguar i detyrimit të qirase</i>	(4,625)	(4,674)
<i>Interesi i llogaritur dhe paguar</i>	43	134
<i>Rregullim diferencave nga kursi i kembimit</i>	(37)	(125)
<b>Totali i detyrimit të qirase</b>	<b>1,121</b>	<b>3,465</b>

**24. SNRF 16 "Qiratë" (vazhdim)**

i) Detyrime afatgjata	-	-
ii) Detyrime afatshkurtra	1,121	3,465

**Pasqyra e te ardhurave / shpenzimeve**

	31/12/2022	31/12/2021
Shpenzimi amortizimit i te drejtes se perdorimit te aktivitet me qira	(4,246)	(4,227)
Shpenzimi i interesit mbi detyrimin e qirase	(43)	(134)
Anullimi i shpenzimit te qirase te njohur sipas IAS 17	4,625	4,674
<b>Efkti i njohur ne fitimin kontabel para tatimit</b>	<b>337</b>	<b>312</b>
Detyrimi tatimor i shtyre i njohur si shpenzim ne lidhje me diferencen e perkohshme (te tatueshme) midis vleres kontabel dhe tatimore te qirase	(50)	(47)
<b>Efkti ne te ardhurat gjithperfishrese</b>	<b>286</b>	<b>266</b>
<b>Transferuar ne rezultatin financiar te vitit</b>	<b>(286)</b>	<b>(266)</b>

**25. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR**

Një instrument financiar është çdo kontratë që bën të mundur krijimin e një të drejte për të marrë mjete monetare ose aktive të tjera financiare nga një palë tjetër (aktiv financiar), ose krijimin e një detyrimi për t'i transferuar mjete monetare ose aktive të tjera financiare një pale tjetër (detyrim financiar). Instrumentat financiarë e ekspozojnë Shoqërinë ndaj disa rreziqeve. Më të rëndësishmet janë paraqitur më poshtë.

**a) Rreziku i kredisë**

Instrumentat financiarë, të cilat e bëjnë Shoqërinë subjekt të rrezikut të kredisë, konsistojnë kryesisht në llogari të arkëtueshme të tjera dhe mbajtje të parave. Rreziku i kredisë i Shoqërisë manaxhohet duke vendosur mjetet e saj monetare në institucione financiare me cilësi të lartë.

Maksimumi i rrezikut të kredisë ndaj të cilit Shoqëria është e ekspozuar në datën e pasqyrës së pozicionit financiar është si më poshtë:

**a) Rreziku i kredise (vazhdim)**

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Llogari të arkëtueshme tregtare	138,469	60,788
Para në bankë	154,229	87,027
<b>TOTALI</b>	<b>292,698</b>	<b>147,815</b>

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Brenda afatit dhe jo të zhvlerësuar	292,698	147,815
Mbas afatit por jo të zhvlerësuar	-	-
Të zhvlerësuar	-	-
<b>TOTALI</b>	<b>292,698</b>	<b>147,815</b>

**b) Rreziku i likuiditetit**

Shoqëria siguron vazhdimësi të financimeve. Huatë e saj janë të ndara në hua dhe qira financiare. Fleksibiliteti afatshkurtër arrihet duke mbajtur mjete të mjaftueshme monetare dhe duke përdorur lehtësirat e overdraftit, sipas nevojës. Më poshtë janë paraqitur maturitetet e kontraktuara të aktiveve dhe detyrimeve financiare, duke përfshirë edhe pagesat e interesit deri më 31 dhjetor 2022 dhe 2021:

**Microsoft Albania sh.p.k.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***25. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (vazhdim)**

<b>31 dhjetor, 2022</b>	<b>Vlera Kontabël</b>	<b>Më pak se 6 muaj</b>	<b>Më shumë se 1 vit</b>
<i>Aktive financiare</i>			
Llogari te tregtueshme tregtare	138,469	98,831	39,638
Paraja dhe ekuivalentet e saj	154,229	154,229	-
<b>Totali</b>	<b>292,698</b>	<b>253,060</b>	<b>39,638</b>
<i>Detyrime financiare</i>			
Te ardhura te shtyra	10,882	10,882	-
Llogari te pagueshme dhe te tjera	28,023	28,023	-
<b>Totali</b>	<b>38,905</b>	<b>38,905</b>	<b>-</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>253,793</b>	<b>214,155</b>	<b>39,638</b>
<b>31 dhjetor, 2021</b>	<b>Vlera Kontabël</b>	<b>Më pak se 6 muaj</b>	<b>Më shumë se 1 vit</b>
<i>Aktive financiare</i>			
Llogari te tregtueshme tregtare	60,788	19,471	41,317
Paraja dhe ekuivalentet e saj	87,027	87,027	-
<b>Totali</b>	<b>147,815</b>	<b>106,498</b>	<b>41,317</b>
<i>Detyrime financiare</i>			
Te ardhura te shtyra	11,524	11,524	-
Llogari te pagueshme dhe te tjera	9,506	9,506	-
<b>Totali</b>	<b>21,030</b>	<b>21,030</b>	<b>-</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>126,785</b>	<b>85,468</b>	<b>41,317</b>

**c) Rreziku i kursit të këmbimit**

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut nga kursi i këmbimit sidomos në lidhje me financimet përmes qirave financiare si dhe në lidhje me komisionet nga Microsoft Corporation në lidhje me marketingun dhe aktivitetet e zhvillimit. Këto marrëveshje më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë kryer në USD. Shoqëria nuk ka përdorur instrumenta derivative për të kufizuar ekspozimin e saj ndaj rrezikut nga kursi i këmbimit dhe normat e interesit. Aktivitetet dhe detyrimet e Shoqërisë sipas monedhave më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë si më poshtë:

<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>Vlera Kontabël</b>	<b>EUR</b>	<b>USD</b>	<b>LEK</b>
<i>Aktive financiare</i>				
Llogari tregtare te arketueshme	138,469	-	138,246	223
Mjete monetare dhe ekuivalente	154,229	-	2,533	151,696
	<b>292,698</b>	<b>-</b>	<b>140,780</b>	<b>151,919</b>

**25. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (vazhdim)****c) Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)***Detyrime financiare*

Detyrimi kontraktual	10,882	-	10,882	-
Llogari tregtare te pagueshme	28,023	-	696	27,327
	<b>38,905</b>	-	<b>11,578</b>	<b>27,327</b>
<b>Ekspozimi neto</b>	<b>253,794</b>	-	<b>129,202</b>	<b>124,592</b>

	<b>Vlera</b>			
<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>Kontabel</b>	<b>EUR</b>	<b>USD</b>	<b>LEK</b>

*Aktive financiare*

Llogari tregtare te arketueshme	60,788	3,777	56,788	223
Mjete monetare dhe ekuivalente	87,027	-	2,734	84,293
	<b>147,816</b>	<b>3,777</b>	<b>59,522</b>	<b>84,517</b>

*Detyrime financiare*

Detyrimi kontraktual	11,524	-	-	11,524
Llogari tregtare te pagueshme	9,506	-	-	9,506
	<b>21,030</b>	-	-	<b>21,030</b>
<b>Ekspozimi neto</b>	<b>126,785</b>	<b>3,777</b>	<b>59,522</b>	<b>63,486</b>

	<b>31 Dhjetor 2022</b>	<b>31 Dhjetor 2021</b>
EUR/USD vlerësuar me 10%	12,920	6,330
EUR/USD vlerësuar me 10%	(12,920)	(6,330)

**d) Rreziku i normave të interesit**

Rreziku i normave të interesit është rreziku që vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të luhaten për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të ndryshimeve në normat e interesit të tregut ka të bëjë kryesisht me detyrimet afatgjata të qerasë financiare me norma interesi të ndryshueshme. Shoqëria nuk angazhohet në instrumenta mbrojtës.

**26. ANGAZHIME DHE GARANCI***Çështje gjyqësore*

Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë procesi gjyqësor, padie apo çështje gjyqësore të ngritur gjatë aktivitetit normal të biznesit.

**27. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT**

Pas datës së raportimit nuk ka patur ndonjë ngjarje domethënëse, e cila do të kërkonte ndryshime apo paraqitje shtesë në pasqyrat financiare.

Kontrata e qirasë për zyrat me adresë Rruga Papa "Gjon Pali II", ABA Business Center, Kati 12/5, 1000, Tirana, Shqipëri, përfundoi në Mars 2023. Zyrat e reja të Shoqërisë ndodhen në Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr. 27, Kati 5, Njësia bashkiake nr. 10, Tiranë, Shqipëri.